

VENDIM
Nr. 416, datë 15.5.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 89, DATË 16.1.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR CAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË
MASËS SË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN
RURAL, PËR VITIN 2013”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i katërt i pikës 4.22 të vendimit nr. 89, datë 16.1.2013 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, riformulohet si më poshtë vijon:

“4.22 Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, t’i shtohet fondi prej 200 (dyqind) milionë lekësh nga Fondi i Kontigjencës, i miratuar për vitin 2013 për të përballuar efektet financiare të këtij kompensimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha